

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7815
E premtë, 21 qershor
2024 Çmimi 0.50 €

Të riparohet a të mbyllet? Dilemat për Kosovën A



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

HAPEN OBSERVATORI DHE PLANETARIUMI I PARË KOMBËTAR I KOSOVËS.

FAQE 4-5



Në fshatin Rashincë të komunës së Shtimes janë përfunduar Observatori dhe Planetariumi i parë Kombëtar në Kosovë. Nga tani qytetarët

e Kosovës në Observator dhe Planetarium do të mund të bëjnë vrojtimin e diellit me teleskop, shfaqje shkencore në planetarium, vrojtimin e

qiellit gjatë natës dhe punëtori praktike me teleskop të udhëhequr nga astronautë me repute botërore

KURTI DHE VUÇIQI DO TË TAKOHEN MË 26 QERSHOR

F. 3



PARAQITEN ARRITJET DHE REZULTATET E PROJEKTIT TË BE-së PËR REFORMIMIN E SISTEMIT TË DREJTËSISË NË KOSOVË

F. 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT




'EURO 2024' SJELL SONTE SUPER- PERBALLJEN HOLANDË - FRANCË

F. 10

KOSOVA NË PRESION POLITIK, KURSE SHBA-JA DHE GJERMANIA MILIARDA INVESTIME NË SERBI

F. 8

Shkruan:
Safet
GËRXHALIU



RIZVANOLLI NË FORUMIN EKONOMIK KOSOVË - PORTUGALI PARAQITI TË ARRITURAT NË SEKTORIN E ENERGJISË

F. 8

BE-JA PRITET T'I HEQË PJESËRISHT DHE GRADUALISHT MASAT NDAJ KOSOVËS

F. 2

KONJUFCA: SULMI NË BANJSKË ISHTË GODITJE E RËNDË PËR SIGURINË E RAJONIT

F. 6

NDËRRON JETË ANTONIO BELUSHI, VEPRIMTARI I PAEPUR I ÇËSHITJES SHQIPTARE

F. 7

EKONOMI

AKTUALE



AKTUALE

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja pritet t'i heqë pjesërisht dhe gradualisht masat ndaj Kosovës

BRUKSEL, 20 QERSHOR - Në Bashkimin Evropian nuk ka pajtim të plotë për heqjen e masave ndëshkuese të vendosura ndaj Kosovës, por si kompromis pritet që këto masa të hiqen pjesërisht dhe gradualisht.

Kështu mësoi Radio Evropa e Lirë nga burimet diplomatike në bllok pas diskutimeve që u zhvilluan më 19 qershor në Komitetin për Politikë dhe Siguri të BE-së (PSC), ku morën pjesë përfaqësuesit e shteteve anëtare.

Sipas burimeve, shumica e shteteve të BE-së ishin në favor të heqjes së plotë të masave, siç edhe ka rekomanduar përfaqësuesi i lartë i bllokut për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, në raportin që ua dorëzoi vendeve anëtare më 18 qershor, lidhur me hapat që Kosova ka ndërmarrë për uljen e tensioneve në veriun e banuar me shumicë serbe.

Në raportin e tij, siç raportoi Radio Evropa e Lirë, Borrelli

rekomandoi që Kosovës t'i hiqeshin masat, ndërkaq Prishtina ta shfrytëzojë këtë mundësi për të vepruar në mënyrë që të ulen tensionet dhe t'i shmangë veprimet e pakoordinuara. Ai këtë konstatim e bëri pas një shqyrtimi të hollësishëm të hapave që Kosova ka ndërmarrë për përmbushjen e kriterëve specifikë që BE-ja i vendosi Kosovës në qershorin e vitit 2023.

Sipas burimeve diplomatike, disa vende të BE-së janë shprehur se "përmbushja e kërkesave nga ana e Kosovës nuk ka qenë e plotë" dhe aktualisht këto shtete nuk pajtohen që Kosovës t'i hiqen të gjitha masat. Diplomatët e BE-së, me të cilët ka kontaktuar Radio Evropa e Lirë, thanë se në ditët në vijim mund të pritet edhe një deklaratë në emër të BE-së, përmes së cilës do të njoftohet për gatishmërinë e heqjes graduale dhe të pjesshme të masave ndaj Kosovës.



Ende nuk ka hollësi rreth asaj se cilat masa do të mund të largoheshin e cilat jo. Por, diplomatët e BE-së janë të mendimit se së pari do të mund të hiqen masat që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e mjeteve financiare nga Instrumentet e Para-Anëtarësimit (IPA), të cilat janë pezulluar për Kosovën. Zyrtarë të BE-së kishin diskutuar për herë të parë rreth mundësisë

së heqjes së masave në prill të këtij viti, andaj edhe kanë kërkuar një raport prej Borrellit. Masat ndaj Kosovës ishin vendosur para një viti si përgjigje ndaj përshtetëzimit të situatës së sigurisë në veri të Kosovës, kur kryetarët shqiptarë - të dalë nga zgjedhjet që u bojkotuan nga serbët lokalë - nisën detyrën e tyre në komunat në veri. Ndër masat e BE-së janë

suspendimi i përkohshëm i punës i trupave të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Kosova, po ashtu, nuk ftohet në ngjarjet e nivelit të lartë dhe vizitat bilaterale janë suspenduar, përveç atyre që fokusohen në adresimin e krizës në veri të Kosovës në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja.

Propozimet e dorëzuara nga Kosova në kuadër të Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) nuk janë paraqitur për shqyrtim në bordin e këtij fondi. Kontratat e reja, ku autoritetet e Kosovës janë përfituese, tash për tash janë të ndalura.

Autoritetet në Kosovë disa herë kanë insistuar se kanë përmbushur kërkesat për heqjen e masave dhe se situata në veri të Kosovës është shtensionuar, serbët e Kosovës kanë pasur mundësi të votojnë për shkarkimin e kryetarëve të komunave dhe tash, sipas tyre, nuk ka më arsye të mbahen këto masa.

Dy të vrarë dhe tre të plagosur nga një shpërthim në Cetinjë



CETINJE, 20 QERSHOR - Si pasojë e aktivizimit të një pajisjeje shpërthyes në Cetinjë të Malit të Zi janë vrarë dy persona dhe tre të tjerë janë plagosur, njoftoi policia më 20 qershor. Petar Kalugjeroviq dhe Dragan Roganoviq janë vrarë në vendngjarje, ndërkaq viktima e tretë vdiq në spitalin në Cetinjë për shkak të plagëve të marra.

Një nga tre të plagosurit, Taso Jovanoviq, 46 vjeç, u transferua në Qendrën Klinike në Podgoricë, ndërkaq Desanka Vujoviq dhe Mihailo Borožan po trajtohen në

spitalin në Cetinjë. Autoritetet shëndetësore në Mal të Zi njoftuan se të gjithë të plagosurit janë jashtë rrezikut për jetë. Shpërthimi ndodhi pas orës 09:00 të 20 qershorit në hyrje të Qendrës së Sportit, që gjendet afër një shkolle fillore dhe një stacioni të autobusëve. "Zyrtarët e Drejtorisë së Policisë, në koordinim me Zyrën e Prokurorit të Shtetit në Podgoricë po ndërmarrin masa dhe veprime intensive, për të cilat publiku do të informohet", njoftoi policia.

Një numër i madh i zyrtarëve policorë kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe autoritetet kanë nisur hetimet për këtë shpërthim.

Për shkak të fuqisë së shpërthimit, xhamat në ndërtesën e Qendrës së Sportit janë thyer dhe një pemë është rrëzuar, raportoi RTV Cetinje. Televizioni shtetëror i Malit të Zi la të kuptohet se shpërthimi është i lidhur me grupet kriminale të këtij vendi të përfshira në kontrabandën e narkotikëve. Sipas raportimit, "disa nga viktimat ishin të porsaliruar nga burgju".

ShBA-ja pritet ta rinisë operimin e portit për ndihma në Gazë

WASHINGTON, 20 QERSHOR - Porti i përkohshëm i ushtrisë amerikane në Gazë pritet ta rinisë operimin për ta mundësuar dërgimin e ndihmave të nevojshme humanitare për palestinezët, thanë dy zyrtarë amerikanë.

Zyrtarët, të cilët folën për agjencinë "Reuters" në kushte anonimiteti, thanë se porti është rilidhur me bregun në Gazë të mërkurën, pasi ishte shkëputur përkohësisht të premten e kaluar për shkak të

kushteve të këqija në det. Ndihma për në Gazë nisi të dërgohej përmes portit të përkohshëm të ndërtuar nga ShBA-ja më 17 maj dhe Kombet e Bashkuara thanë se përmes këtij porti janë transportuar 137 kamionë me ndihma apo rreth 900 tonë metrikë.

Por, më pas kushtet e këqija në det dëmtuan portin dhe dëmet u riparuan. Përveç kushteve atmosferike, edhe shqetësimet e sigurisë kanë kufizuar numrin e ditëve kur ky port ka qenë

funksional.

Në mars presidenti amerikan Joe Biden kishte njoftuar për vendosjen e këtij porti të përkohshëm, me qëllim të lehtësimit të dërgesave të ndihmës humanitare, teksa Gaza, ku jetojnë 2.3 milionë banorë, po përballet me uri, e lufta në mes të Izraelit dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - po vazhdon.



Paraqiten arritjet dhe rezultatet e projektit të BE-së për reformimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 20 qershor - Ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ka marrë pjesë në konferencën përmbyllëse të projektit Eukojust, në të cilën janë paraqitur qëndrimet e tyre mbi reformën në sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Të pranishëm në këtë ngjarje ishin e ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu dhe përfaqësues të këshillit gjyqësor dhe prokurorial.

Projekti Eukojust, me një buxhet prej 7 milionë eurosh, filloi zbatimin në tetor të vitit 2020, me qëllim të përmirësimit të sistemit të drejtësisë së Kosovës në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Ky projekt është zbatuar bashkërisht me aktorët kryesorë: Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës (KGJK dhe KPK), Akademinë e Drejtësisë dhe Zyrën Ligjore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Përpjekjet e tyre të përbashkëta kishin për qëllim forcimin e koordinimit brenda sektorit të drejtësisë dhe lehtësimin e zbatimit të strategjisë për sektorin e sundimit të ligjit.

Ambasadori Szunyog, së bashku me ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, dhe figura të tjera të shquara, shprehën pikëpamjet e tyre mbi efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të drejtësisë në Kosovë, si dhe përparimin e arritur në reformat e drejtësisë në kuadër të projektit Eukojust.

Projekti ndihmoi institucionet e drejtësisë së Kosovës në konsolidimin e kornizës ligjore dhe institucionale, forcimin e pavarësisë, paanshmërisë, përgjegjësisë, profesionalizmit, cilësisë, efikasitetit dhe transparencës së gjyqësorit, si dhe përmirësimin e qasjes në drejtësi për çdo qytetar, veçanërisht për gratë dhe grupet e cenueshme ose të marginalizuara.

Projekti ka arritur rezultate të rëndësishme në katër objektivat e tij kryesore.

Në aspektin e "Forcimit të kapaciteteve dhe koordinimit ndërinstitucional", projekti mbështeti institucionet e drejtësisë në arritjen e Deklaratës së Përbashkët të Zotimit për shtimin e veprimeve të përbashkëta drejt avancimit të mëtejshëm të sundimit të ligjit në Kosovë.

U krijua një Mekanizëm Koordinues Ndërinstitucional; u zhvillua një Plan Veprimi për vlerësimin e sistemit TIK në sektorin e drejtësisë; dhe u lehtësuan organizimi dhe sistematizimi i brendshëm i Ministrisë së Drejtësisë. Për më tepër, projekti ndihmoi në hartimin e Manualit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Çështjet Civile dhe Penale, si dhe në zhvillimin e Planit Strategjik 2022 - 2025 për KPK-në.

"Pavarësia, paanshmëria dhe llogaridhënia" janë përmirësuar falë këshillave dhe mbështetjes së vazhdueshme të ofruar nga projekti.

Në veçanti, ka pasur mbështetje të vazhdueshme në drejtim të



llogaridhënie, reformës së administratës dhe avancimit në karrierë për prokurorët; Është ofruar mbështetje për ndryshimet ligjore lidhur me përgjegjësinë disiplinore të prokurorëve; formimi i Komitetit të Etikës për prokurorët; është përmirësuar cilësia e të dhënave të mbledhura nga gjyqësori, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes; zhvillimi i sistemit të E-dosjeve për KGJK-në si dhe digjitalizimi i regjistrave të gjykatave për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Në aspektin e "konsolidimit, harmonizimit dhe zbatimit të legjislacionit", projekti ka mbështetur institucionet e Kosovës në ndjekjen e qasjes së re

tematike e cila e përdor legjislacionin e BE-së si pikënisje për harmonizimin e legjislacionit të Kosovës. Gjithashtu, është realizuar një proces efektiv i pastrimit të legjislacionit të Kosovës nga e kaluara. Në kuptimin praktik, projekti mbështeti institucionet e drejtësisë në reformën e rëndësishme ligjore me hartimin e Kodit të Procedurës Civile; Ligjit për Gjykatën Administrative; Ligjit për Dhomën e Posaçme; Ligjit për të Drejtën për Gjykim të Drejtë dhe vlerësimin ex-post të akteve juridike.

Janë përmirësuar "qasja në drejtësi" për grupet e cenueshme dhe fuqizimi i komuniteteve

përmes sesioneve informative ligjore, si dhe ngritja e kapaciteteve për përkthyesit dhe interpretët e KGJK-së, KPK-së dhe MD-së. Forcimi i koordinimit të donatorëve për çështjet kyçe për ta shmangur dyfishimin e veprimeve është një tjetër rezultat i mbështetjes së projektit për institucionet e Kosovës në këtë fushë.

Projekti zbatohet nga Fondacioni Gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ) si partner udhëheqës së bashku me partnerët e projektit: Qendra për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (CILC; Holandë) dhe Ministria e Drejtësisë e Kroacisë.

Kurti dhe Vuçiqi do të takohen më 26 qershor

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, do të takohen në Bruksel më 26 qershor, për ta zhvilluar raundin e ri të dialogut për normalizim të raporteve që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. Takimi është konfirmuar nga zëdhënësi i BE-së, Peter Stano. Por, nga blloku evropian ende nuk ka hollësi lidhur me agjendën e takimit Kurti - Vuçiq.

Ky takim i nivelit të lartë në kuadër të dialogut do të ndërmjetësohet nga përfaqësuesi i lartë i bllokut për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, dhe i dërguari i posaçëm për dialogun, Miroslav Lajçak.

Për mbajtjen e raundit të ri të dialogut është rënë dakord gjatë vizitave që Lajçaku ka zhvilluar në Kosovë dhe Serbi gjatë kësaj



jave. Për herë të fundit Kurti dhe Vuçiqi u takuan në Bruksel më 14

shtator të vitit 2023, kur diskutuan për zbatimin e Marrëveshjes në rrugën drejt

normalizimit të raporteve, por ky takim rezultoi pa ndonjë përparim për shkak të

qëndrimeve kontradiktore të palëve.

Disa ditë më vonë, më 24 shtator, një grup i serbëve të armatosur sulmuan policinë e Kosovës në fshatin Banjskë të Zveçanit në veri të Kosovës, duke vrarë një polic. Gjatë përlëshjeve që pasuan u vranë edhe tre sulmues serbë.

Kosova e akuzon Serbinë se qëndron prapa sulmit, por Beogradi mohon se ka gisht në të. Që atëherë Perëndimi është përpjekur disa herë t'i bindë Kurtin dhe Vuçiqin që të ulen në tryezën e bisedimeve për të diskutuar për hapat për zbatimin e marrëveshjes.

Kjo marrëveshje - e cila u arrit vitin e kaluar - nuk është nënshkruar nga palët, por BE-ja thotë se është ligjërish e obligueshme për Kosovën dhe Serbinë. Kosova kërkon që të nënshkruhet marrëveshja, por Serbia refuzon.



Të riparohet a të mbyllet? Dilemat për Kosovën A

PRISHTINE, 20 QERSHOR - Jo të gjithë pajtohen se investimet në Termocentralin Kosova A, që i parashikon Qeveria e Kosovës, janë të nevojshme.

Mbështetësit argumentojnë se ato duhen për të garantuar sigurinë energjetike, por kritikët nxjerrin në pah ndikimin në ndotjen e ajrit dhe infrastrukturën e vjetruar të termocentralit.

Termocentrali Kosova A - i cili gjeneron rrymë me thëngjill, është i vjetër me dekada dhe i ka dy blloqe jashtë funksionit - ka qenë e paraparë të mbyllet deri në vitin 2017 me Marrëveshjen e Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore.

Kjo nuk ka ndodhur dhe Qeveria e tashme e Kosovës e ka përfshirë atë në Strategjinë për Energji 2022-2031, e cila parasheh investime.

Korporata Energjetike e Kosovës, e cila ka nën menaxhim Termocentralin Kosova A dhe Termocentralin tjetër Kosova B, nuk iu përgjigj pyetjeve të Radios Evropa e Lirë nëse kanë filluar investimet dhe sa do të jetë vlera e tyre.

Ngjashëm as Ministria e Ekonomisë e Kosovës, e cila ka hartuar Strategjinë për Energji.

Çfarë kapaciteti ka Kosova A?

Rreth 35 për qind e konsumatorëve të Kosovës

varen nga prodhimi i rrymës i Termocentralit Kosova A.

Ky termocentral përbëhet prej pesë blloqesh. I pari i tij, A1, ka nisur prodhimin në vitin 1962, ndërsa i fundit, A5, më 1975.

Për shkak të vjetërsisë, dy blloqe të tij nuk funksionojnë fare.

Kosova A dhe Kosova B - të dyja me thëngjill - plotësojnë 80 për qind të nevojave të Kosovës për rrymë.

Në vitin 2020, Kosova dhe vende të tjera të Ballkanit Perëndimor kanë nënshkruar Deklaratën për Agjendën e Gjellbër, përmes së cilës janë zotuar se, deri në vitin 2050, do t'i japin fund prodhimit të energjisë nga thëngjilli dhe do të kalojnë në burime të ripërtërishme.

Strategjia për Energji 2022-2031 e Kosovës përqendrohet tek investimet në këto burime, por një pjesë përfshin edhe Termocentralin Kosova A, përkatësisht investimet në së paku një njësi apo bllok të tij.

Në dokument thuhet se njëra njësi do të rinovohet deri në fund të vitit 2024, ndërsa vendimi për rinovimin ose mbylljen e njësisë së dytë do të merret më së voni më 2024.

"Njësia e riparuar do të punojë si rezervë strategjike nga viti 2028 deri në vitin 2030 dhe do të jetë në dispozicion në sezonin e ngrohjes, kur kërkesa për energji elektrike është më e lartë, ose në raste të krizave energjetike", thuhet në dokument.

A ka Kosova alternativa?

Për Dardan Abazin, ekspert i politikave të energjisë në Institutin për Politika Zhvillimore në Kosovë, INDEP, investimi në blloqe të vjetruara, që do të shfrytëzoheshin në kohë krizash, është "argument i dobët".

Ai thotë se prioritet duhet të kenë investimet në burimet e ripërtërishme, ndërsa në raste krizash alternativë mund të jenë vendet e rajonit. "...sepse, Kosova e ka bashkuar tashmë tregun energjetik me Shqipërinë përmes bursës ALPEX", thotë ai, duke iu referuar një marrëveshjeje të vitit 2020.

Me këtë marrëveshje, dy vendet, përmes Bursës Shqiptare të Energjisë (ALPEX), mund të sigurojnë energji për konsumatorët e njëra-tjetrës, me planifikim një ditë përpara. Zeqir Veselaj, profesor i lëndës "Edukimi mjedisor për zhvillim të qëndrueshëm" në Universitetin e Prishtinës, problemin e investimit në termocentrale me thëngjill e sheh te ndotja e ajrit.

Këto termocentrale të Kosovës janë ndër ndotësit më të mëdhenj në Evropë, ka vlerësuar në vitin 2019 grupi i OJQ-ve mjedisore në Evropën Qendrore dhe Lindore, "Bankwatch Network". "Kam rezerva se a mund të jenë

produtive ato investime, me parametra të pranueshëm mjedisorë, në një termocentral që i ka mbushur më shumë se 50 vjet", thotë Veselaj. "Në kushte normale, [Termocentrali Kosova A] është dashur të hiqej nga përdorimi, ashtu siç është planifikuar vite më parë", thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Por, ish-drejtori i Korporatës Energjetike të Kosovës, Arben Gjukaj, konsideron se investimet në Kosovën A janë të nevojshme, meqë ajo mbulon rreth 35 për qind të nevojave për rrymë. "Kosova ka burime të kufizuara alternative", thotë Gjukaj. "Vonesat në ndërtimin e njësive të reja do të kishin pasoja afatgjate për sektorin e energjisë, edhe ashtu të rënduar", thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Në Institutin për Politika Sociale "Musine Kokalari" në Prishtinë vlerësojnë, po ashtu, se Kosova nuk ka as mundësi financiare e as resurse të tjera për të bërë një tranzicion të shpejtë në energjinë e ripërtërishme.

Andaj, thuhet në një deklaratë të këtij instituti për REL-in, është e rëndësishme që të investohet përkohësisht në termocentralet ekzistuese, por duke u vendosur elektrofiltra, që do të minimizonin ndotjen e ajrit.

Aktualisht, mbi 20 për qind e energjisë elektrike në Kosovë

prodhohet nga burimet alternative, si: hidrocentralet, centralet me erë dhe panelet me diell.

Ministrja e Ekonomisë e Kosovës, Artane Rizvanolli, ka thënë më herët se synim i vendit është që pas vitit 2031, 35 për qind e energjisë elektrike të gjenerohet nga burimet e ripërtërishme.

Pse nuk është mbyllur Kosova A?

Në vitin 2017, kur është thënë se do të mbyllet Kosova A, ka qenë e paraparë të hynte në funksion termocentrali i ri Kosova e Re.

Ky projekt është rishikuar dhe shtyrë disa herë dhe në fund nuk është realizuar.

Banka Botërore, fillimisht, i ka dhënë mbështetje, por më pas është tërhequr, duke deklaruar se nuk do ta mbështesë më ndërtimin e një termocentrali me thëngjill.

Më pas është tërhequr edhe kompania fituese e tenderit për ndërtimin e tij, Contour Global. Nevojat e Kosovës për energji elektrike i tejkalojnë kapacitetet e prodhimit, sidomos gjatë dimrit.

Kosova ka kapacitet të prodhojë rreth 800 megavate në orë, kurse nevojat e saj, në ditë dimri, arrijnë deri në 1.300 megavate në orë.

Këtë diferencë, ajo zakonisht e importon nga jashtë.

Hapen Observatori dhe Planetariumi i parë Kombëtar i Kosovës



Në fshatin Rashincë të komunës së Shtimes janë përruar Observatori dhe Planetariumi i parë Kombëtar në Kosovë. Nga tani qytetarët e Kosovës në Observator dhe Planetarium do të mund të bëjnë vrotimin e diellit me teleskop, shfaqje shkencore në planetarium, vrotimin e qiellit gjatë natës dhe punëtori praktike me teleskop të udhëhequr nga astronautë me renome botërore

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

SHTIME, 20 QERSHOR - Në fshatin Rashincë të komunës së Shtimes janë përruar Observatori dhe Planetariumi i parë Kombëtar në Kosovë, ndërtimi i të cilëve ka kushtuar mbi 300 mijë euro dhe po konsiderohet të jetë ndër ngjarjet më të veçanta dhe historike për vendin tonë.

Të pranishëm në këtë përrurim ishin ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, deputetë të Kuvendit të Kosovës, bashkëpunëtorë, astronomë nga ShBA-ja, me përfaqësues të

rëndësishëm të donatorëve ndërkombëtarë e qytetarë. "Ky është premtim i përmbushur dhe një inovacion unik për vendin tonë. Observatori dhe Planetariumi do të ofrojnë mundësi të shkëlqyera për edukimin shkencor dhe eksplorimin e hapësirës qiellore duke dhënë mundësi për shtim të diturisë për nxënësit, studentët dhe të gjithë entuziastët e astronomisë. Gjithashtu, komuna jonë përmes këtij projekti do të shndërrohet në një atraksion shkencor turistik ku do të marrë vëmendje të gjerë ndërkombëtare për hulumtime astronomike, falë edhe faktit se këtu ndodhet edhe

teleskopi më i madh për vrotim në Evropën Lindore, që përfundimisht na vendos në hartën e lokacioneve me rëndësi strategjike për kërkime shkencore astronomike.

Faleminderit të gjithë aktorëve që kontribuuan në realizimin e këtij projekti të jashtëzakonshëm", ka thënë kryetari i komunës së Shtimes, Qemajl Aliu.

Ndërsa ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka thënë se çdo mundësi e re për t'i zgjeruar horizontet tona, na bënë të reflektojmë më thellë për kontributin e jashtëzakonshëm të shkencës në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm. "Jam e lumtur të jem në inaugurimin e Observatoriumit dhe Planetariumit, që janë madhështia dhe bukuria e universit, që zgjojnë interesin kolektiv në masë të gjerë. Kjo mundësi jo vetëm po u ofron kushte të nevojshme për hulumtim shkencëtarëve tanë, por është një stimulim i jashtëzakonshëm për të rinjtë e të rejtat që janë të magjepsur nga hapësira dhe kozmosi dhe duan të dinë më shumë për to. Çdo

mundësi e re për t'i zgjeruar horizontet tona na bënë të reflektojmë më thellë për kontributin e jashtëzakonshëm të shkencës në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm, zbulimin e të kuptuarit të dukurive hapësinore. Gjithashtu u shërben të gjithë njerëzve të këtij planeti blu, sepse na vetëdijeson për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit në kohë sfidash mjedisore", ka thënë Nagavci.

Edhe Corey Lee, drejtor i Celestron, donator i observatorit, u shpreh i lumtur për ndërtimin dhe përrurimin e këtij observatori dhe tha se kjo nuk është vetëm një ndërtesë, por rezultat i një udhëtimit të jashtëzakonshëm të mbushur me pasion dhe këmbëngulje. "Nuk është thjesht një ndërtesë, por rezultat i një udhëtimit të jashtëzakonshëm të mbushur me pasion dhe këmbëngulje. Ne jemi të lumtur të ofrojmë më të mirën tonë", ka theksuar Lee.

Ndërsa Stephen Ramsden, donator i Teleskopit Diellor më të madh në Evropën Lindore, ka theksuar se që nga viti 2015, kur kishte kontaktuar me

themeluesen e organizatës së Astronomisë (AOK), Pranvera Hyseni, kanë dërguar teleskopë në Kosovë. "Organizatën time e drejtoj me disa miq. Ne i mbështesim njerëzit në të gjithë botën që punojnë shumë dhe bëjnë atë që thonë se do të bëjnë. Ne jemi shumë krenarë që jemi këtu dhe e di që është shumë nxehtë jashtë, por ju lutem e jani dhe mos ngurroni të flisni me mua për çdo gjë në lidhje me këtë. Ne jemi super krenarë për të. Njerëzit këtu e duan ShBA-në më shumë sesa ata në ShBA", ka pohuar Ramsden.

Marrëveshja e mirëkuptimit për realizimin e projektit "Ndërtimi i Observatorit dhe Planetariumi i parë në Kosovë" mes ministres së Arsimit, Nagavci dhe kryetarit Aliu ishte nënshkruar para dy vitesh dhe është bashkëfinansim mes MASHTI-t dhe komunës së Shtimes.

Nga tani qytetarët e Kosovës në Observator dhe Planetarium do të mund të bëjnë vrotimin e diellit me teleskop, shfaqje shkencore në planetarium, vrotim të qiellit gjatë natës dhe punëtori praktike me teleskop të udhëhequr nga astronautë me renome botërore.



KEDS-i investon në komunën e Vushtrrisë mbi 500 mijë euro

VUSHTRRI, 20 QERSHOR - Në kuadër të planit investiv njëvjeçar, KEDS-i po bën implementimin e projekteve kapitale nëpër lokalitete të shumta të Kosovës. Një projekt i tillë në komunën e Vushtrrisë tashmë është formësuar. Mu te nënkalmi i fshatit

Nadakovc, i cili është në ndërtim e sipër, buzë rrugës që çon kah fshatrat Sfarçak, Novolan, Samadregjë e deri në Ceceli e Sllakovc, i është shtuar një linjë komplet e rrejtje elektrike. KEDS-i ka vendosur nja 400 shtylla të reja të betonit, bashkë me përçues elektrike dhe gjashtë transformatorë

të rinj, si dhe stabilimente të tjera të nevojshme elektroenergjetike, të cilat përshkojnë një gjatësi prej rreth 15 kilometrash. Ky projekt, i njohur si Nadakovc dhe i përfunduar para pak kohësh, hyn në kuadër të një projekti kapital, kostoja e përgjithshme e të cilit është

550 mijë euro. Aktualisht aty po bëhet eliminimi i rrejtje të vjetër elektrik, i cili ishte instaluar para shumë kohësh dhe nëpër terrene shpeshherë vështirë të qasshme për mirëmbajtjen e tij. Projekti Nadakovc është vetëm një nga 250 projektet që KEDS-i planifikon t'i



implementojë gjithandej nëpër Kosovë përgjatë këtij viti.

Konjufca: Sulmi në Banjskë ishte goditje e rëndë për sigurinë e rajonit

SHKUP, 20 QERSHOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka marrë pjesë në përmblyllje të punimeve të seancës së 11-të plenare të Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore. "Së bashku me delegacionin e Republikës së Kosovës, në prani të pritësit, z. Afrim Gashi, kryetarit të Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, si dhe pjesëmarrësve të tjerë nga delegacionet e vendeve të rajonit të Evropës Juglindore, kisha kënaqësinë të merrja pjesë dhe ta mbaja fjalën time në këtë seancë të 11-të plenare të Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEEC PA) të mbajtur në Shkup. Takime të tilla janë rikonfirmim i angazhimit të përbashkët për të nxitur bashkëpunimin rajonal, për të promovuar zhvillimin ekonomik, për të rritur sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin në Evropën Juglindore. Aty theksova



se vizioni për bashkëpunim dhe për arritje të aspiratave të përbashkëta përmban ndër të tjera në vetvete edhe njohjen e Republikës së Kosovës nga të gjitha vendet e këtij rajoni, në mënyrë që t'i hapet rruga gjithëpërfshirjes dhe bashkëpunimit të plotë e të mirëfilltë", ka shkruar Konjufca në "Facebook". Njëkohësisht Konjufca ka thënë se ka vënë në dukje nevojën për

ta mbështetur aspiratën e Kosovës për anëtarësim në struktura ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Këshillin e Evropës, në frymën e përkushtimit për një rajon sa më të bashkuar rreth vlerave dhe qëllimeve të përbashkëta. "Një gjë e tillë u arrit më herët me liberalizimin e vizave për qytetarët e vendit tonë, gjë për të cilën jemi mirënjohës dhe kjo duhet të përsëritet, në frymën e

të ardhmes së përbashkët. Në fjalën time, nënvizova edhe se ngjarja e 24 shtatorit 2023, kur kundër Republikës së Kosovës u krye një sulm i egër terrorist, me pasojë vrasjen e rreshterit Afrim Bunjaku dhe plagosjen e dy policëve të tjerë, ishte goditje e rëndë jo vetëm për bashkëpunimin, por edhe për sigurinë dhe stabilitetin rajonal. Prandaj, ai akt duhet dënuar nga të gjithë pa përjashtim, ndërsa përgjegjësit të cilët strehohen dhe mbrohen nga Serbia duhet të vihen përballë drejtësisë. Pa këto qëndrime dhe veprime, do të jetë e vështirë të arrihen synimet e SEEC PA", ka thënë ai. Konjufca gjatë fjalës së tij ka potencuar përparimin e jashtëzakonshëm që ka bërë Republika e Kosovës në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, në qeverisjen demokratike dhe të drejtat e njeriut, në luftën kundër korrupsionit, në rritjen e transparencës dhe llogari-

dhënies. "Ky progres, i njohur edhe nga organizata të ndryshme ndërkombëtare, është një dëshmi e përkushtimit tonë për të ndërtuar një shoqëri të gjallë, demokratike dhe gjithëpërfshirëse. Në përfundim të fjalës sime, bëra thirrje që të punojmë së bashku duke riafirmuar përkushtimin ndaj parimeve të barazisë, gjithëpërfshirjes dhe bashkëpunimit rajonal, për t'u siguruar që asnjë anëtar i komunitetit tonë të mos marginalizohet dhe të sigurohemi që Strategjia për Evropën Juglindore 2030 të përmbushë premtimin e saj për të mos lënë askënd pas dhe për të nxitur një rajon ku çdo shtet mund të lulëzojë. Në përmblyllje të punimeve të seancës së 11-të plenare të Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, dolëm me një deklaratë të përbashkët finalizuese", ka thënë Konjufca.

Promovohet libri monografik "Shqiptarët dhe serbët - e vërteta kundër të pavërtetës" i Shyqri Nimanit

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Në Galerinë Kombëtare të Kosovës është promovuar libri monografik "Shqiptarët dhe serbët - e vërteta kundër të pavërtetës" i Shyqri Nimanit. Ministria e Kulturës ka njoftuar se ky vëllim monografik, në shqip dhe anglisht, që ka gjithsej 23 kapituj, shqyrton çështje të rëndësishme ndërmjet popullit shqiptar dhe atij serb gjatë shekujve, që zgjojnë interesim të jashtëzakonshëm. "Autori na

ofron kumte për ekzistencën e mjaft kishave të rëndësishme dhe artefakteve të çmueshme që gjenden në vendet fqinje e që historikisht i takonin trojeve etnike shqiptare, duke demaskuar kështu një numër të madh të pavërtetave që serbët i kanë plasuar", thuhet në njoftimin e MKRS-së. Para shumë të pranishmëve, familjarëve, historianëve, albanologëve, shkrimtarëve, Albani, djali i Shyqri Nimanit, tha



se libri ka qenë i përfunduar pak para se babai i tij të ndërronte jetë, dhe tregoi se është libri i tetë i koleksionit të hulumtimit të

historisë shqiptare e i parafundit, pasi ka lënë edhe një dorëshkrim tjetër që pritet të botohet së shpejti. Rreth diskutimit të librit monografik folën historianët Jusuf Buxhovi, Pëllumb Xhufi dhe poeti Lulzim Tafa, të cilët theksuan ky libër demaskon gënjeshttrat hegemoniste serbe në planin kulturor dhe historik, si dhe krahas materialeve të shumta që ofron, ka sjell dokumente, harta e fotografi të shumta të

papublikuara më parë. Autori i këtij libri ndërroi jetë më 22 qershor 2023 dhe mbetet ndër emrat më të rëndësishëm të kulturës shqiptare, i cili la pas një pasuri të madhe të veprave të ndryshme shkencore dhe artistike. Ai ishte shkruesi i Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës. Promovimi i monografisë është organizuar në përkujdesjen e Ministrisë së Kulturës në kuadër të 25-vjetorit të çlirimit.

Policia, fushatë vetëdijësuese: 'Festo me zemër, jo me armë'

PRIZREN, 20 QERSHOR - Drejtoria Rajonale e Policisë në Prizren, stacionet policore, kanë filluar implementimin e planit operativ "Sezoni veror 2024", ku gjatë kësaj periudhe kohore pritet të ketë organizime dhe manifestime të ndryshme (dasma, ahengje familjare), dhe, me këtë rast, policia është duke zhvilluar një fushatë vetëdijësuese në

zonën e përgjegjësisë. Gjatë këtyre aktiviteteve, përpos shpërndarjes së fletëpalosjeve me këshilla për vetësiguri, në disa lokacione të cilat janë më të frekuentuara, kanë vendosur edhe postierë të cilët bëjnë thirrje vetëdijësuese të qytetarët me moton: 'Festo me zemër, jo me armë (sa më pak armë, më pak tragjedi).

Drejtoria Rajonale e Policisë në Prizren u bënë thirrje qytetarëve që të kenë kujdes të shtuar, ta respektojnë ligjin duke iu përmbajtur rregullave dhe duke u sjell me kujdes ndaj njëri-tjetrit në mënyrë që të ndikojmë në zvogëlimin e numrit të lëndimeve dhe pasojave nga përdorimi i armëve dhe mjeteve të tjera.



Ndërron jetë Antonio Belushi, veprimtari i paepur i çështjes shqiptare

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Ka ndërruar jetë Antonio Belushi, prifti arbëresh, veprimtari i shquar i çështjes shqiptare. Presidentja Vjosa Osmani ka shprehur ngushëllime për ndarjen nga jeta të atë Antonio Belushit, ndërsa thekson se është humbje e madhe për arbëreshët e Kalabrisë. “Me dhimbje të thellë mora lajmin për kalimin në amshim të Atë Antonio Belushit, veprimtarit të paepur të çështjes shqiptare, i cili përveç se kultivoi me pasion gjuhën arbëreshe, nga vitet ‘90, bashkë me presidentin Rugova e veprimtarë të tjerë, e mbrojti të drejtën e shqiptarëve për liri. Ndarja e tij nga jeta është humbje e madhe për familjen e miqtë, kishën arbëreshe, institucionet e popullin arbëresh të Kalabrisë e gjithë Italisë së

Jugut. Si presidente e Kosovës kam pasur nderin ta takoja në bibliotekën e pasur të tij, të cilën e krijoi dhe e mbajti me aq përkushtim deri në vdekje. Si presidente e vendit, kur ia akordova shtetësinë e Kosovës, ishte i stërlumtur, sepse e iu plotësua dëshira e tij jetësore. I përhershëm qoftë kujtimi për Atë Antonio Belushin”, ka theksuar Osmani.

Veprimtari Bardhyl Mahmuti ka kërkuar që të shpallet ditë zie për vdekjen e Atë Antonio Belushit. Në “Facebook”, ai ka thënë se Atë Antonio Bellusci pasqyrore hulumtuesin e përkushtuar të kulturës ilire-shqiptare, studimet etnografike të të cilit hodhën dritë mbi trashëgiminë gojore të arbëreshëve në Itali dhe Greqi. “Të shpallet Ditë Zie për Atë

Antonio Bellusci! Me pikëllim të madh morëm lajmin për vdekjen e Atë Antonio Bellusci, që pasqyrore hulumtuesin e përkushtuar të kulturës iliro-shqiptare, studimet etnografike të së cilit hodhën dritë mbi trashëgiminë gojore të arbëreshëve në Itali dhe Greqi. Në momentet më të rënda të historisë së popullit shqiptar të Kosovës, në kohën kur shteti serb zbatonte planin gjenocidal ‘Patkoi’, Atë Antonio Bellusci e denoncoi me tërë forcën intelektuale në opinionin publik të Italisë! Në shenjë nderimi për këtë atdhetar dhe humanist të madh, Kuvendi i Kosovës duhet të mbajë një seancë të jashtëzakonshme dhe të shpallë ditë zie!”, ka shkruar Bardhyl Mahmuti në “Facebook”.



Bislimi: Kosova synon anëtarësimin në OKB, BE, NATO dhe në Këshill të Evropës



PRISHTINË, 20 QERSHOR - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, mori pjesë në pritjen e organizuar nga Ambasada e Britanisë në Kosovë, me rastin e Ditëlindjes së Madhërisë së Tij, Mbretit Charles III.

Në fjalën e tij, ai shprehu se Mbretëria e Bashkuar mban një vend të veçantë në zemrat dhe mendjet tona, për mbështetjen e vazhdueshme ndaj Kosovës. “Në rrugëtimin tonë për liri, Mbretëria e Bashkuar ka qenë gjithmonë një

aleat i palëkundur - një komb që përkrah lirinë dhe vlerat demokratike, që na qëndruan pranë gjatë luftës dhe përpjekjeve tona për çlirim, dhe vitet pasuese të rindërtimit të vendit tonë. Javën e kaluar pritëm ish-kryeministrin Tony Blair për të shënuar së bashku 25 vjet nga çlirimi i Kosovës. Ne e vlerësojmë shumë dhe nuk do ta harrojmë kurrë mbështetjen e tij të palëkundur gjatë luftës”, tha zëvendëskryeministri.

Më tej ai shtoi se Kosova është tashmë një shtet i cili synon anëtarësimin në OKB, BE, NATO,

Këshill të Evropës, dhe që po fuqizon themelet e demokracisë dhe lirisë, të drejtave civile dhe sundimit të ligjit. “Në aspiratat dhe rrugëtimin që kemi përpara, ne kemi besim se me mbështetjen e Mbretërisë së Bashkuar dhe aleatëve tanë perëndimorë do t'i arrijmë qëllimet tona, teksa marrëdhëniet tona diplomatike, vizitat dypalëshe, bashkëpunimi dhe lidhja ndërmjetore po forcohen dita-ditës. Një lidhje më e thellë në politikë, kulturë, ekonomi, siguri dhe shumë fusha të tjera”, tha zëvendëskryeministri Bislimi.

Gjuriqi: Dialogu Kosovë - Serbi është në komë

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Marko Gjuriqi, tha se dialogu në mes të Prishtinës dhe Beogradit është “në komë”. Kjo gjendje, sipas tij, nuk ka të bëjë asgjë me përfaqësuesin e posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun, Miroslav Lajçak, por me faktin se shtetet që kanë ndikim nuk e përdorin atë. Në një intervistë për transmetuesin publik të Serbisë, Gjuriqi njoftoi për aktivitet intensiv diplomatik, duke theksuar se Parlamenti i ri Evropian është konstituuar dhe disa gjëra po ndryshojnë në

Evropë. Sipas tij, viti i ardhshëm “mund të jetë viti në të cilin situata do të jetë më e favorshme”.

Përfaqësuesi i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Mirollav Lajçak, qëndroi në Serbi më 19 qershor. Gjatë vizitës ai u takua me presidentin e Serbisë Aleksandar Vuçiq dhe shefin e diplomacisë, Marko Gjuriqi.

Përmes një postimi në “Instagram”, Vuçiqi tha se me Lajçakun kanë biseduar për zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit dhe për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Sipas tij, zbatimi i këtyre



dy marrëveshjeve do ta mundësonte kthimin në një dialog konstruktiv mes dy shteteve.

Një ditë më herët Lajçaku qëndroi edhe në Prishtinë, ku u takua me kryenegociatorin e Kosovës, Besnik Bislimi. Zyrtari i lartë evropian deklaroi se Kosova dhe Serbia duhet të ndërmarrin hapa për zbatimin e Marrëveshjes në rrugën drejt normalizimit të raporteve, duke përkujtuar se nga kjo varet edhe qasja në fonde të BE-së.

Vitin e kaluar Kosova dhe Serbia u pajtuan për Marrëveshjen në rrugën drejt normalizimit të

raporteve dhe për Aneksin për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Marrëveshja prej 11 nenesh, ndër të tjera, parashihet edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut.

Megjithatë, BE-ja - e cila që nga viti 2011 ndërmjetëson dialogun për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë - ka kritikuar palët për moszbatimin e marrëveshjes.

Dren Boshnjaku zgjidhet kryesues i Bordit Drejtues të ShSKUK-së

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës ka zgjedhur Dren Boshnjakun kryesues të këtij bordi. “Në mbledhjen e 52 të mbajtur me datë 20.06.2024 konform dispozitave ligjore, me 6 vota për dhe një votë të pavlefshme, në mandat

njëvjeçar ka zgjedhur kryesues të Bordit Drejtues, dr. Dren Boshnjakun. Bordi Drejtues i ShSKUK-së me këtë rast ka vlerësuar dhe falënderuar për kontributin e deritanishëm ish-kryesuesin dr. Naim Bardiqi dhe anëtarin e deritanishëm të Bordit Drejtues të ShSKUK-së, dr.

Besim Demolli. Kryesuesi dr. Boshnjaku në fjalën e tij ka falënderuar anëtarët e Bordit Drejtues për besimin e dhënë dhe ka premtuar angazhim maksimal në funksion të ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore nga ShSKUK”, është bërë me dije në njoftimin për medie.



Kosova në presion politik, kurse ShBA-ja dhe Gjermania miliarda investime në Serbi



Shkruan: Safet GËRXHALIU,
ish-kryetar i Odës
Ekonomike të Kosovës

Bazuar në raportet ekonomike vërehet se investimet nga ShBA-ja në Serbi janë mbi 4 miliardë dollarë në vitet e fundit dhe kanë krijuar afër 30 mijë vende të punës në këtë vend. Kjo dëshmon për mbështetjen ekonomike që shtetet e Bashkuara të Amerikës i japin këtij vendi me efekte pozitive shumëdimensionale.

Nga investimet e Gjermanisë në Serbi janë hapur mbi 100 mijë vende pune dhe këmbimi tregtar mes Serbisë dhe Gjermanisë është rritur në mbi 8 miliardë euro në të dyja anët.

Stabiliteti politik, një diplomaci aktive qoftë politike dhe ekonomike kanë arritur të tërheqin

vëmendjen e investitorëve amerikanë dhe gjermanë në Serbi, dhe të përfitojnë në aspektin ekonomik, politik, gjeostrategjik e në veçanti në përmirësimin e imazhit të këtij vendi.

Në Kosovë çdo gjë është e politizuar, qoftë nga pushteti vendor po ashtu edhe nga faktori ndërkombëtar duke bërë presion shumë më tepër në koncesione politike se sa në zhvillim ekonomik të Kosovës.

Se sa janë efektive investimet amerikane dhe të Gjermanisë e dëshmon rritja e eksporteve, shërbimeve dhe mallrave. Shfrytëzimi i këtyre indikatorëve për të promovuar këtë shtet si destinacion për të investuar.

Marrëdhëniet e mira ekonomike me ShBA-në, janë parakusht për tërheqjen e investimeve të reja dhe mbajtjen e investimeve ekzistuese. Serbia aktualisht ka bashkëpunim dypalësh, politik dhe ekonomik në rritje me Amerikën.

Në njëzet vitet e fundit, kompanitë amerikane kanë investuar më shumë se katër miliardë dollarë dhe kanë punësuar me shumë se 30,000

qytetarë. Niveli i shkëmbimit të shërbimeve është rritur aq shumë sa Amerika është partneri numër një kur bëhet fjalë për eksportimin, kryesisht IT, shërbimeve nga ky vend.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat krijuan bashkëpunim me kompani gjermane, pesë prej të cilave u renditën në mesin e 15 eksportuesve më të mëdhenj "vendas", ku vendin e parë të asaj "Bundes League" të eksportuesve në vitin 2023 është ZF S me eksporte prej 504.8 milionë euro, e ndjekur nga Leoni Wiring Systems Southeast me 489.3 milionë, Robert Bosch me 453 milionë, Henkel me 405 milionë dhe Hemofarm me 351.9 milionë euro. Përveç tyre, gjithsej 1126 kompani nga Serbia eksportojnë në Gjermani. A duhet të përmendim veçanërisht se nuk ka asnjë kompani të vetme pronari i së cilës është shumica nga Serbia në top listën e 15 eksportuesve më të mëdhenj "serbë"? Kompanitë e huaja, mes të cilave janë pak më shumë se 900 gjermane, nuk erdhën në këtë vend për tregun e

brendshëm, por për të tregtuar atë që prodhojnë këtu për klientët nga disa vende të tjera. Kompanitë gjermane do të punësojnë drejtpërdrejt 100,000 qytetarë në Serbi deri në fund të vitit 2024.

Në fund të fundit, në janar 2023, tregtia ndërmjet Serbisë dhe Gjermanisë ishte rreth dy miliardë euro dhe që atëherë është rritur në 8.2 miliardë euro. Në vitin 2014, sipas të dhënave zyrtare të Institutit Republikan të Statistikave, këmbimi total i mallrave ndërmjet Serbisë dhe Gjermanisë ishte pothuajse 3.2 miliardë euro, ndërsa në vitin 2013 ishte 2.9 miliardë euro.

Vitin e kaluar u shënuar një rekord i ri, eksportet u rritën në 4.3 miliardë euro, ndërsa importet në 4.8 miliardë euro. Ky trend vazhdoi edhe këtë vit, kështu që në katër muajt e parë, eksportet u rritën me gjashtë për qind, në 1.5 miliardë euro, ndërsa importet me 9.6 për qind, në 1.7 miliardë euro. Nuk janë vetëm ShBA-ja dhe Gjermania të pranishme me investime në këtë vend por edhe Turqia, Austria, Italia, Japonia etj.

Nga e tëra kjo vërehet një padrejtësi që i bëhet Kosovës në rrafshin politik që po reflekton edhe në aspektin ekonomik nga faktorë ndërkombëtarë.

Kosova duhet ta marrë fatin e zhvillimit ekonomik në duart e veta drejt të ardhmërisë së vet ekonomike duke arritur stabilitet politik, partneritet me miq ndërkombëtarë, depolitizim të ekonomisë, orientim në kuadro me bagazh profesional dhe jo vetëm përkatësi politike dhe forcim të diplomacisë politike, e në veçanti asaj ekonomike që të promovojë Kosovën kudo në botë, të përmirësojë imazhin e saj dhe të i bindin të tjerët e në veçanti investitorët potencial se Kosova është shumë më e mirë nga brenda se sa që duket nga jashtë. Republika e Kosovës është një realitet i kohës i pranuar ndërkombëtarisht dhe krahas ndihmës politike nga faktori ndërkombëtar ka nevojë për mbështetjen ekonomike si garanci e stabilitetit politik, social, integruar dhe barazisë rajonale si parapërgatitje për integrim në BE, OKB dhe në NATO.

Rizvanolli në Forumin Ekonomik Kosovë - Portugali paraqiti të arriturat në sektorin e energjisë



PRISHTINË, 20 QERSHOR - Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, mori pjesë në Forumin Ekonomik Kosovë - Portugali, ku paraqiti sektorët kryesorë të Ministrisë së Ekonomisë, me theks energjinë dhe Teknologjinë Informativë dhe Komunikuese.

Ministrja Rizvanolli u shpreh e kënaqur me faktin që më shumë se 40 biznese nga Portugalia erdhën për herë të parë në rajon përmes Forumit Ekonomik Kosovë - Portugali, e kjo tregon një hap të rëndësishëm drejt thellimit të lidhjeve dhe bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Portugalisë.

Në një forum të tillë pas tre

vjetësh qeverisje, Rizvanolli paraqiti projektet e mëdha energjetike që kanë filluar duke shfaqur suksesin e ankandit të parë solar 100 MW dhe ankandet e tjera të radhës që janë pjesë e pakos investive, ku ME synon të ndërtojë 950 MW kapacitete të reja të energjisë së ripërtëritshme, me një investim total prej 1.2 miliardë eurosh.

E përmes kësaj synohet të ofrohet siguri dhe mundësi të mëdha për investitorët ndërkombëtarë. "Kosova ofron një fuqi punëtore të re dhe shumë të kualifikuar, ndërsa Portugalia sjell ekspertizën e saj në inovacionin digjital. Kjo sinergji ndërmjet talentit të teknologjisë në

zhvillim të Kosovës dhe infrastrukturës digjitale të avancuar të Portugalisë do të ofrojë një partneritet digjital transformues, duke i shtyrë vendet tona drejt bashkëpunimit dhe rritjes ekonomike", ka theksuar ministrja Rizvanolli.

Në këtë ngjarje, përveç ministres Rizvanolli, morën pjesë edhe nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës, Saranda Bogujevci, nënkryetari i Kuvendit të Portugalisë, Marcos Perestrello, ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, afaristë dhe të ftuar të tjerë.

Deputeti Shala: Është ndërprerë puna në Trepçë, menaxhmenti dhe qeveria po përpiqen ta mbajnë të fshehur

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, ka thënë se nga 14 qershori 2024 është ndërprerë procesi i punës në minierën e Stantërgut. Shala në "Facebook" ka shkruar se është e habitshme dhe e pashpjegueshme se si menaxhmenti i kësaj ndërmarrje dhe qeveria po përpiqen ta mbajnë të fshehur çështjen e ndërprerjes së punës.

"Trepça ndërpret punën. Nga data 14 qershor 2024, në minierën e Stantërgut është ndërprerë procesi i punës. E habitshme dhe e pashpjegueshme se si menaxhmenti i kësaj ndërmarrje dhe qeveria, përpiqen ta mbajnë të fshehur çështjen e ndërprerjes së punës. Ky veprim paraqet shkallë të lartë të humbjeve ekonomike për ndërmarrjen Trepça,

njëkohësisht edhe shkallë të lartë të rrezikut për gjendjen e përgjithshme për sigurinë në minierë. Tashmë u vërtetohet që kjo qeveri jo vetëm që nuk ka kuadro, por nuk ka plan e as ide për Trepçën dhe industrinë minerare. Nëse vazhdohet me këtë logjikë të kësaj qeverie, dëmet strategjike për sektorin dhe Trepçën do të jenë katastrofale!", ka shkruar Ferat Shala.



Njeriu i dy mileniumeve

Nga: Ali PODRIMJA

1.

Askush nuk mund të demantojë se nuk kam jetuar në dy mileniume. Të dytin e mbylla me një klithmë njerëzore. Të tretin do ta hap se çfare ka. Brisku i berberit vazhdon të vizullojë prapë. Edhe mileniumi i ri nuk do të jetë pa probleme. Ndonjë mik i pavarur ende, do ta lë epitafin: lindi në mileniumin e dytë, të tretin as e grithi.

2.

Do t'i kem mbi një mijë vjet. E dashura ajo e ditës së parë: e freskët, e bukur dhe e pavdekshme ...

3.

Ata që nuk e përjetuan, as nuk ia panë surratin mileniumit të dytë, do thonë: çfarë njerëz paskan qenë baballarët, nuk paskan ditur të vdesin. Deri në kohë tonë gdhijnë!

4.

Në mes dy mileniumeve ndodhën vërtet çudira mbi çudira.


Vizuelisht e lexuam Biblën moderne. Kjo ndodhi para një mijë e një viti. Një Bllacë kisha mbledhur fjalët e therura. I solla në mileniumin e ri. Mund të bëni ç'dëshironi me to.

5.

Ne kishim probleme të tjera. Mbetëm kokëfortë se besonim në dinjitetin njerëzor. Na gëzon nëse kush gurin e vë në vendin e vet.

6.

Do të flitet si për diçka tepër, tepër të largët. Kjo ngjarje ka ndodhur në mileniumin e dytë, do të thonë. Kishin arritur të shpëtojnë nga xehnemii ca libra dhe një flamur. Më pak do të dëgjohej se shqiptarët ishin njëri nga dy popujt më të vjetër të Ballkanit dhe gjuha shqipe ishte e dymbëdhjeta gjuhë botërore, siç e mbështeti këtë edhe një shkrimtar i hershëm. Me ardhacakë do të ketë telashe prapë. Nuk mund të shkulet nga mesjeta, e cila paska ekzistuar tash e një mijë e pesëqind vjet më parë. Por, deri ku qenka shtrirë Vilajeti i Kosovës?



7.

Udhëtimi i mëtutjeshëm varet te organizimi. Do e bëjmë udhën si fis apo komb? Na pëlqeftë nocioni i parë, mileniumin e ri vetëm do ta prekim. Ndokush mund të shkruajë: në Ballkan kanë ekzistuar edhe ca fise. Po qe se mbështesim nocionin e dytë, do të mundim të keqen. Prapë fqinj veriorë do t'i kemi fiset sllave dhe grekët do t'i luten zotit të tyre të mos zbresim më poshtë. Vetëm

shkami të ne mbet fatkeqësi.

8.

Detrat tanë do të lagin çdo pëllëmbë të tokës sonë, e cila zdirgjet e del nga ta. Besoj se më të copëtuar nuk do të jemi. Do ta gjejmë edhe ne zotin tonë. Mund të ketë edhe ndonjë luftë. Por, kufiri kohor shqiptar mbetet Bllaca. Tej vitit 1999 dardanët shtriheshin deri aty, në mileniumin e tretë arritën deri këtu.

9.

Shkaktar do të jetë Evropa për gjithçka që ndodh me ne. Kur të kthehen ata me Liburnë, lëjuni hapur librat tanë të moçëm ... I besojnë këtij shkrimi ata që pranojnë se nuk kanë kremtuar asnjë përvjetor të rëndësishëm. Vargun e thënë në mileniumin e dytë Kosova është gjaku im që nuk falet, më vjen keq edhe në të tretin të përsëritet. Fundi kurrë nuk dihet.

10.

Shoh se çdo gjë jona ka mbi një mijë vjet. Të kujtojmë ku ishim, ose rrotën e historisë ta luajë ai që nuk beson. Rileximi i ngjarjeve bëhet i tmerrshëm. Një telefonatë nga mileniumi i kaluar: a sheh, na bëjnë shtet! Në këtë qyshk, e moti ishim, i them, por nuk ditëm ta mbajmë, se nuk kishim Zot ... Më i vjetër se dy mileniume jam megjithatë. Ngris dollinë për dashurinë që vazhdon të ndritë udhën teht të lepit. /Javorja "Zëri", 2000/Telegrafi/

Skenaristi më i famshëm i listës së zezë të Holivudit

Nga: Greg MCKEVITT / BBC (titulli: 'I went spectacularly broke': The blacklisted Hollywood writer who won two Oscars)

Kur BBC intervistoi skenaristin Dalton Trumbo, pranë pishinës së tij në Holivud në vitin 1960, ai sapo kishte shkruar skenarët për dy nga filmat më të mëdhenj të vitit. Pavarësisht këtij suksesi të shpejtë, intervistuesi Robert Robinson tek ai vërejti një "përmbajtje të caktuar", duke supozuar se "nuk kishte dëshirë të ringjallte grindjet e vjetra". Nuk është çudi nëse ndihej paksa i lënduar.

I burgosur, i futur në listën e zezë nga Holivudi dhe i detyruar për të punuar në fshetësi nën një mori të emrave të rremë, 13 vjetët e fundit Trumbo i kaloi duke u goditur nga gjuetia amerikane antikomuniste e shtrigave. Gjithçka që kishte bërë ishte refuzimi i vitit 1947 që t'i tregonte një komiteti të qeverisë amerikane nëse ishte komunist, pasi mendonte se sipas Amendamentit të Parë e kishte të drejtën ligjore për të pasur cilëndo pikëpamje politike që ai dëshiron. Sigurisht, Trumbo ishte anëtar i Partisë Komuniste, por puna nuk ishte këtu dhe, sidoqoftë, ai ishte larg stereotipit "I kuq". Më vonë i tha BBC-së: "Kurrë nuk e ndjeva fajin më të vogël për të bërë atë që meritoja – filmat fitonin milionat. Nëse do të merrja një hise të vogël, mirë, kjo do të më pëlqente. Ideja e fajit – nuk jam puritan – do të më kishte befusuar".

I lindur në vitin 1905, karriera e



Trumbos si skenarist merr hov në vitet 1930 dhe në fund të dekadës ishte një nga skenaristët më të paguar të Holivudit. Në atë kohë, Hollivudi ishte i veçuar nga më i keqi i Depresionit i Madh, fal eskapizmit të tij popullore dhe fitimprurës në një botë të trazuar, por ndërgjegjja e fortë shoqërore po tronditej mes disave në industrinë e zbavitjes. Më vonë, në vitin 1973 Trumbo i tha BBC-së: "Njerëzit u bashkuan Partisë Komuniste sepse i bënë gjërat që ata mendonin se duheshin bërë. E kundërshtonte ngritjen e fashizmit në të gjithë Evropën. Ndihamonte ata që ishin refugjatë".

Komiteti i Dhomës së Përfaqësuesve për Aktivitetet Jo-Amerikane (HUAC), i cili më vonë u bë i famshëm për ashpërsinë ndaj të industrisë së filmit, u formua në vitin 1938 për të hetuar tendencat "subversive" – si ndërlidhjet komuniste. Megjithatë, me ardhjen e Luftës së Dytë Botërore, u bë ndryshimi i

lojalitetit ndaj aleatëve më të çuditshëm. Pushtimi i Adolf Hitlerit dhe Gjermanisë naziste në Bashkimin Sovjetik, në vitin 1941, nënkuptonte se Rusia komuniste e Stalinit ishte befusale e SHBA-së.

Holivudi bëri të pamundurën në përpjekjet e luftës, me disa filma pro-sovjetikë si Misioni në Moskë [Mission to Moscow] i vitit 1943. Regjisor i tij, Michael Curtiz, e kishte fituar një vit më parë Oscarin për regjinë më të mirë për Kazablankën [Casablanca].

Por, kur lufta mbaroi, u shkatërrua aleanca e përhumbësive e SHBA-së dhe Bashkimin Sovjetik, duke sjell epokën e re të paranojës së Luftës së Ftohtë. Ky shqetësim për kërcënimin e perceptuar të komunizmit, ishte mjedis i përsosur për HUAC-në për të zgjeruar ndikimin e vet.

Në vitin 1947, Trumbo ishte një nga dhjetë skenaristët dhe regjisorët e Holivudit në tribunën e seancave dëgjimore mbi propagandën e supozuar komuniste në biznesin e filmit.

Atyre vazhdimisht iu shtrua pyetja: "A je tash apo ke qenë ndonjëherë anëtar i Partisë Komuniste"?

Në përgjigje, Trumbo tha: "Besoj se e kam të drejtë të ballafaqohem me çdo provë që mbështet këtë pyetje. Do të doja të shihja se çfarë keni". Përgjigja e tij nuk shkoi mirë. Të gjithë në "Dhjetëshen e Holivudit" refuzuan dëshminë dhe u shpallën fajtorë për shpërfillje të Kongresit.

Siç Trumbo ia kujtoi Robert Robinsonit të BBC-së në vitin 1960, drejtuesit e studios u mblodhën një takim në hotelin Waldorf-Astoria të Nju-Jorkut ku njoftuan vendimin për dhjetë burrat në listën e zezë. Ai tha: "E bënë njoftimin se dhjetë personat që kishin refuzuar të zbulonin para komisionit përkatësinë e tyre politike, nuk do të punësoheshin më në industrinë e filmave të Holivudit – siç e quanin ata. Urrej ta quaj industri".

Teksa HUAC ishte organ i profilit të lartë i hetimeve antikomuniste, të dyshuarit e tjerë të Holivudit u vunë në shënjestër në mënyrë më tinëzore nga një pamflet i quajtur Kanalet e të kuqve [Red Channels], i botuar në vitin 1950. Mes të implikuarve ishin aktorët Edward G. Robinson dhe Orson Welles, shkrimtarët Arthur Miller dhe Dashiell Hammett, muzikantët Leonard Bernstein dhe Aaron Copland dhe interpretuesit Lena Horne dhe Burl Ives.

Me nëntitullin "raporti i ndikimit komunist në radio dhe televizion", futja në listë mjaftoi për të dëmtuar apo edhe për të ta përfunduar karrierën. Pasojat për

Trumbos ishin edhe më të rënda. Në të njëjtin muaj që u publikua Kanali, Trumbo shkoi në burg për bindjet e veta ose, siç i tha BBC-së me ironi, "Më dhanë strehë dhe akomodim të shkëlqyeshëm në Institucionin Federal Korrektues në Ashland të Kentakit – për një vit".


Me lirinë e tij nga burgu, lista e zezë e zhbëri emrin dhe reputacionin e Trumbos. Në pamundësi për të gjetur punë në Kaliforni, me familjen e vet u transferua në Meksiko-Siti. Ai tha: "Kam qëndruar dy vjet atje. Nuk isha i lumtur. Gjithashtu, shkova me xhepat bosh. Dhe, u ktheva dhe që atëherë kemi jetuar këtu". Në pamundësi për të shkruar skenarë duke përdorur emrin e vet, duhej t'i drejtohej tregut të zi për të mposhtur listën e zezë. "Kisha metoda për anashkalim, në mënyrë që të mos isha kurrë plotësisht i papunë", pranoi ai për BBC-në.

"Megjithatë, personat që ishin në gjendje të rrezikonin për shërbimet e mia, pra të rrezikonin që marrëdhënia ime me filmin të mos zbuloheshin për të mos e dëmtuar filmin, bënin filma më pak të shtrenjtë dhe kështu fitova shumë më pak para".

U detyrua të shkruante me një sërë pseudonimesh ose duke përdorur skenaristët e tjerë për punë e vet. Teksa disa skenarë ishin për filmat B që nuk e kishin prestigjin e punës së tij para listës së zezë, ato përfshinin gjithashtu filmat klasikë si Pushimet romane [Roman Holiday] të vitit 1953, me aktorët Audrey Hepburn dhe Gregory Peck.

/Përkthimi: Telegrafi.com

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Manaj: Synojmë fitore ndaj Spanjës

DORTMUND, 20 QERSHOR - Sulmuesi i Shqipërisë, Rey Manaj, doli në konferencë ditën e sotme. Manaj u shpreh se kuqezinjtë do të luftojnë deri në fund për kualifikimin, edhe pse ky mision duket mjaft i vështirë, pasi përballë do të jetë Spanja. “Kur mbaroi ndeshja

filluam të mendonim. Mund të kishim arritur tri pikët. Goli i dytë mund të jepej faull, por gjyqtari tha që nuk kishte asgjë nga VAR-i. Pak pishman, pasi mund të kishim fituar. Tani duhet të fitojmë ndaj Spanjës”, ka thënë Manaj. “Kemi më shumë shanse nëse fiton

sonte Spanja. Shpresoj të bëjmë historinë. Goli i shpejtë me Italinë na bëri të uleshim shumë. Ndërkohë që ndaj Kroacisë pjesa e parë ishte ndër më të mirat e viteve të fundit. Goli i parë i pësuar na demoralizoi, na destabilizoi pak, por patëm forcë me golin e Klausit dhe

atë që dhanë lojtarët e ardhur nga stoli. Goli është gjëja më e rëndësishme për një sulmues, por jemi ekip kompakt. Rëndësi ka të shënojmë, jo kush shënon”, ka deklaruar Manaj. Shqipëria ndeshjen e fundit e zhvillon ndaj Spanjës të hënën nga ora 21:00.



‘Euro 2024’ sjell sonte superperballjen Holandë - Francë

“Epoka e re”

Leipzig, 20 qershor - Një betejë e gjigantëve të Grupit D në mes të Holandës dhe Francës kryeson ndeshjet e së premtes në “Euro 2024”. Këto dy kombëtare të mëdha përballen nga ora 21:00 në “Red Bull Arena” të Leipzigit me synim për ta siguruar kualifikimin në 1/16 e finales. Holanda e drejtuar nga Ronald Koeman shënoi fitore me përmbysje ndaj Polonisë në ndeshjen e parë, kurse edhe Franca shënoi fitore me rezultat minimal ndaj Austrisë (1-0), por në këtë fitore ylli Kylian Mbappe u lëndua dhe me gjasë do të humbasë dy ndeshjet e radhës në fazën e grupeve.

Kapiteni i Francës, Kylian Mbappe, ka motivuar bashkëlojtarët për të fituar ndaj Holandës. “Nuk duhet të kemi frikë nga asgjë, le të luajmë. Nëse luajmë, çdo gjë do të rregullohet”,


ka thënë Mbappe. Ndeshja tjetër e këtij grupi zhvillohet nga ora 18:00, ku në “Olympiastadion” përballen Polonia dhe Austria. Të dy këto kombëtare patën paraqitje të mira në ndeshjet e para, por nuk arritën t’i shmangën humbje dhe tash do të tentojnë t’i gëzohen fitores së parë. Të premtën zhvillohet edhe një ndeshje e Grupit E ku do të përballen Sllovakia dhe Ukraina. Në ndeshjen e parë, Sllovakia tejkaloi parashikimet dhe mposhti Belgjikën, duke rritur shumë shanset për kualifikim në fazën tjetër. Në anën tjetër, Ukraina pësoi humbje të thellë nga Romania me rezultat 3-0.

GRUPI D

18:00 Poloni - Austri
21:00 Holandë - Francë

GRUPI E

15:00 Sllovakia - Ukrainë



HOLANDË-FRANCË, FORMACIONET E MUNDSHME

Holanda: Verbruggen; Dumfries, De Vrij, Van Dijk, Ake; Schouten, Veerman; Simons, Reijnders, Gakpo; Depay.
Franca: Maignan; Kounde, Saliba, Upamecano, Hernandez; Kante, Rabiot; Dembele, Griezmann, Thuram; Giroud.

Renditja e FIFA-s: Kosova bie për tri pozita, Shqipëria nuk ndryshon



PRISHTINË, 20 QERSHOR - Federata Ndërkombëtare e Shoqatës së Futbollit (FIFA) ka publikuar ranglistën e re të kombëtareve. Kosova, sipas të dhënave të fundit, ka rënë për tri pozita, nga 102 ku ishte më 15 shkurt, në 105 në publikimin e sotëm. Ndërkaq Shqipëria ka mbetur në pozitën e njëjtë, të 66-tën. Kosova në tri ndeshjet e fundit miqësore ka arritur një fitore

dhe dy humbje. Armeninë e mposhti me rezultat minimal 1-0 si mysafire, ndërsa u mposht nga Hungaria dhe Norvegjia me rezultat 2-0, respektivisht 3-0. Shqipëria, në anën tjetër, nga katër miqësoret e zhvilluara nga marsi i këtij viti, ka arritur dy fitore dhe dy humbje, kurse në Evropianin që po zhvillohet aktualisht, deri më tani ka një humbje dhe një barazim. Pozita

e parë, e dytë dhe e tretë mbeten të pandryshuara, me Argentinën, Francën e Belgjikën, kurse Brazili dhe Anglia i kanë ndërruar pozitat nga matjet e fundit, dhe aktualisht gjenden në pozitën 4, respektivisht të 5-të. Në pozitën e 6 është Portugalia, e pasuar nga Holanda, Spanja, Kroacia dhe Italia, që përmbyllin top-10.

Abdixhiku për Edon Zhegrovën: Potenciali që ka është aset kombëtar

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka postuar një fotografi me futbollistin e Përfaqësueses së Kosovës, Edon Zhegrova. Ai ka thënë se

Zhegrova është një djalë i jashtëzakonshëm, i sjellshëm, i dashur dhe përplot me kujdes. Abdixhiku ka shtruar që potenciali i Zhegrovës është aset kombëtar. “Edoni

është një djalë i jashtëzakonshëm. Përveç se talent e profesionist që po shijon e krijon majat e futbollit evropian, ai është dhe i sjellshëm, i dashur e

përplot me kujdes. Prandaj takimet me të janë gjithnjë kënaqësi. Potenciali që ka, ndërsa janë aset kombëtar!”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”.



Visoka, trajner i Drenicës

SKENDERAJ, 20 QERSHOR - Skuadra e Drenicës nga Skenderaj ka arritur marrëveshje me trajnerin Megzon Visoka për ta marrë drejtimin e shtabit teknik. Në ambientet e FC

Drenica dhe në praninë e presidentit Gëzim Ramadani dhe zëvendës-presidentit Çausht Dobra është bërë prezantimi i trajnerit të ri të skuadrës Megzon Visoka. "Klubi njofton

se është arritur marrëveshje me trajnerin prishtinas i cili do të jetë 'timonier' i ekipit për edicionin e ri. Pas emërimit të kryetrajnerit, klubi do ta vazhdojë punën për

kompletimin e skuadrës dhe shumë shpejt do të njoftoheni me të rejtat rreth përfundimit dhe zhvillimit të tjera rreth klubit", thuhet në njoftimin e skuadrës kuqezi.



Todt: Mick Schumacher më i fortë se gjysma e pilotëve të F1

GENOLIER, 20 QERSHOR - Mick Schumacher bëri debutimin e tij në Formula 1 në 2021, një sezon pasi fitoi kampionatin e F2 në 2020-n. Piloti gjerman garoi për dy sezona me Haas dhe në vitin e dytë zhvilloi një kampionat në të cilin ai pati disa kulme të performancës. Veçanërisht në Austri, kur përfundoi garën në vendin e gjashtë, pas vendit të tetë marrë në Britaninë dy javë më herët. Gjithsesi, kjo nuk mjaftoi dhe ai u largua nga Haas, që nuk i rinovoi kontratën. Në dimrin e vitit 2023, Mercedesi zyrtarizoi ardhjen e Mick Schumacherit si pilotin rezervë dhe zhvillimit të makinës. Nga ky vit gjermani është gjithashtu pjesë e Alpines për sa i përket programit WEC në klasën Hypercar, por në pistat e Formula 1 nuk ka zbritur. Dëshira e 25-vjeçarit është padyshim që të rikthehet në Formula 1. Sipas Jean Todt, ka disa faktorë që nuk e ndihmojnë djalin e legjendës Michael Schumacherit: "Nuk e di nëse Mick është një nga pilotët më të mirë, por mund të them se ai është më i mirë se gjysma e pilotëve aktualë të



Formula 1". "Ndoshta Mick është shumë i sjellshëm, ndërkohë që në Formula 1 ju duhet t'i nxirrni bërlyat. Në këtë botë ose kafshon ose të kafshojnë", ka deklaruar Todt. Ai shtoi se mbiemri është aktualisht një disavantazh për Mick Schumacherin: "Shumë mendojnë se është një avantazh, por është kthyer në një disavantazh".

"Pritshmëria e vendosur mbi të ishte e paarsyeshme dhe makina nuk ishte konkurruese. Ai kurrë nuk ishte në gjendje ta tregonte potencialin e tij. Presioni ndaj tij ishte i padrejtë. Unë e di këtë gjë sepse kam qenë edhe drejtor i ekipit Ferrarit, ndaj performanca e një piloti vuan menjëherë nëse ai nuk ndihet rehat", ka pohuar Todt.

Shaqiri: Ndeshjet e mëdha janë për mua

KOLN, 20 QERSHOR - Pas fitores ndaj Hungarisë në ndeshjen e parë, Zvicra u ndal me barazim në të dytën me Skocinë në kuadër të Grupit A të Kampionatit Evropian të Futbollit. Në fakt, "helvetikët" ishin në disavantazh 1-0 pas golit të McTominay në minutën e 13-të, por ishte Xherdan Shaqiri ai që në minutën e 26 realizoi një supergol për të barazuar në 1-1. Pas ndeshjes, Shaqiri ka folur për golin e tij duke thënë se ishte një gol shumë i bukur. "Ishte një gabim i kundërshtarit që e shfrytëzova maksimalisht. Mendova se thjesht do ta hidhja në këndin e shkurtër. Ishte një goditje e përkryer. Është një gol shumë i bukur dhe i rëndësishëm. Ne donim të fitonim. Lojërat e mëdha janë bërë për mua", ka thënë Shaqiri. Më tutje, ai ka shtuar se edhe familja e tij tashmë po pret



g gjithmonë që ai të shënojë gola të tillë. "Familja ime tani pret që unë të shënoj një gol të tillë në çdo turne. Por unë qëndroj në tokë. Dua ta ndihmoj skuadrën. Sot arrita ta bëj këtë me këtë qëllim. Statistikat janë të këndshme për t'u parë. Shpresoj që ato të mbeten në kujtesën tuaj

përgjithmonë. Ishte intensive dhe në fund të ditës ishte një barazim i drejtë", ka deklaruar Shaqiri. Pas dy ndeshjeve, Zvicra ka katër pikë në Grupin A, dy më pak se Gjermania që është liderë e grupit dhe pikërisht këto dy skuadra do të ndeshjen në ballafaqimin e radhës.

SHKURT

AGK-ja dënon kërcënimet me jetë ndaj gazetarit Arlind Sadiku

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës - AGK është i shqetësuar me kërcënimet që ka marrë ditët e fundit gazetarit i sportit në Klan Kosova dhe Art Motion, Arlind Sadiku. Sipas pohimeve të gazetarit, shumë prej kërcënimeve ndaj tij janë me jetë, dhe ato vijnë kryesisht nga Serbia. AGK-a, dënon fuqishëm kërcënimet dhe kërkon që ato të ndalen menjëherë, pasi që cenojnë sigurinë fizike të gazetarit. Sadikut i është tërhequr akreditimi nga UEFA, pasi që në ndeshjen Angli - Serbi ka bërë shqiptarë në drejtim të tifozëve të shtetit fqinj.

Federata Serbe e Futbollit: UEFA t'i ndëshkojë Shqipërinë dhe Kroacinë ose tërhiqemi nga Evropiani

Federata Serbe e Futbollit do t'i kërkojë UEFA-s që t'i dënojë Shqipërinë dhe Kroacinë. Mediet serbe shkruajnë se sekretari i përgjithshëm i Federatës Serbe të Futbollit, Jovan Surbatoviç, ka thënë se tifozët shqiptarë e kroatë kënduan dhe bënë thirrje së bashku kundër serbëve. Ai kërkon që dy kombëtares të dënohen, ose në të kundërt Serbia nuk do të marrë pjesë në Kampionatet Evropiane. "Kjo është skandaloze. Federata do t'i kërkojë UEFA-s që të marrë sanksione. Kjo kërkon dënime më të rënda në mënyrë që të mos përsëritet më. Do të kërkojmë që UEFA t'i ndëshkojë rëndë grupet e Shqipërisë dhe Kroacisë. Ne nuk do të marrim pjesë në kompeticionin evropian nëse nuk dënohen keqbërësit. Presim dënime rigorozë", ka thënë Surbatoviç. Ai u shpreh se ka besim që UEFA do të reagojë, njësoj siç bëri me gazetarin nga Kosova që i hoqi akreditimin në "Euro 2024" pasi bëri simbole shqiptare kundër serbëve në stadium.

Napoli interesohet për Ramadanin

Ylber Ramadani ka qenë padyshim një ndër më të mirët në fushën e blertë për Shqipërinë në dy ndeshjet e para të "Euro 2024". Në këtë mënyrë Ramadani ka tërhequr vëmendjen e klubeve të mëdha, në këtë merkato vere, të cilat janë gati ta bëjnë pjesë të tyre "shkatërruesin" shqiptar. Sipas raportimeve më të fundit të medieve italiane, për kartonin e 28-vjeçarit interesohen tri herë kampionët e Italisë, Napoli, me teknikun Antonio Conte, që duket se e pëlqen shumë stilin e lojës, së djaloshit nga Ferizaj e për këtë arsye kërkon ta ketë "katalizatorin" e mesfushës, në skuadrën e tij. Nëse Ramadani transferohet te Napoli aty do ta gjejë edhe futbollistin tjetër nga Kosova, Amir Rrahmani.

Nagelsmann: Synojmë vendin e parë në grup

Gjermania e ka siguruar kalimin nga faza e grupit me dy ndeshje të zhvilluara ku arriti dy fitore. Ndeshjen e tretë Gjermania e zhvillon ndaj Zvicrës, të dielën në orën 21:00. Trajneri Julian Nagelsmann ka bërë me dije se synimi i parë i gjermanëve është të dalin si fitues të grupit. "Dëshirojmë ta fitojmë grupin. Ky është edhe objektivi ynë i parë në këtë Euro 2024. Ju siguroj që ndaj Zvicrës nuk do të ketë 'turnover'. Në sfidën me Hungarinë kontrolluam shumë mirë lojën, sidomos në pjesën e dytë, kur falë kësaj mënyre loje, ia dolëm të shënonim edhe golin e dytë, për ta mbyllur përfundimisht sfidën", ka thënë Nagelsmann.

Federer: Nëse Nadali më kërkon të luajmë në lojën dyshe jam gati të rikthehem

Më datat 20-22 shtator në Berlin (Gjermani) do të zhvillohet edicioni i radhës së turneut Laver Cup në tenis. Një event i krijuar nga Roger Federer, ku përballë njëra-tjetrës janë skuadrat e

tenistëve nga Evropa dhe ajo e tenistëve nga e gjithë bota. Mes tenistëve që këtë vit ka konfirmuar praninë e tij në ekipin e Evropës është Rafael Nadal, që ende nuk ka vendosur nëse do ta vijojë

karrierën e tij vitin tjetër apo jo. Ka zëra se në këtë turne mund të thotë lamtumirë edhe Nadal, ashtu sikurse pat bërë dy vjet më parë Federeri. Sfidat e fundit e zviceranit ishte loja dyshe me Nadalin dhe pamjet

e asaj sfide, me dy tenistët në lot dhe me duart kapur bënë xhiron e botës. I pyetur nëse do të luajë një tjetër lojë dyshe me Nadalin, tenisti zviceran sqaroi. "Nuk mendoj se do të luajmë së bashku në Laver

Cup, por nëse Rafaeli ma kërkon një gjë të tillë atëherë do të pranoj të luaj sërish me të", u shpreh Roger Federer, duke lënë të hapur një rikthim në fushë për një ndeshje në shtator.



SHPLLJE PËR PRAKTIKANTË

Titulli: Praktikantë, tetë (8) pozita
Departamenti: i Statistikës
Raporton tek: Udhëheqësi i Divizionit të Statistikave të Jashtme

Në kuadër të programit “Praktika profesionale me studentë” Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) shpall konkurs për pranimin e tetë (8) praktikantëve, me kohë të caktuar për një muaj. Objektivi kryesor i këtij programi është që stafi profesional i BQK-së të ndaj përvojat me studentët të cilët do të kryejnë këtë praktikë. Programi i praktikës për studentë u mundëson lidhjen midis njohurive të fituara gjatë studimeve dhe punës praktike në institucionet publike të pavarura. Ky program zgjatë katër javë dhe nuk nënkupton në asnjë mënyrë marrëdhënie formale pune me BQK-në.

Studentët do të angazhohen drejtpërdrejt në realizimin e një projekti studimor për të vlerësuar nivelin dhe strukturën e shpenzimeve të diasporës kosovare gjatë qëndrimit në Kosovë. Projekti mbikëqyret nga Departamenti i Statistikës në BQK. Si pjesë e projektit, studentët do të zhvillojnë anketa në terren në disa pika të përzgjedhura kufitare të Kosovës gjatë periudhës së verës 2024.

Njohuritë e kërkuara:

- Kandidatët duhet të jenë studentë në studime universitare ose në studime pasuniversitare, në fushën e ekonomisë, statistikës, matematikës ose drejtime të ngjashme;
- Të kenë aftësi të mira komunikimi dhe të punës ekipore;
- Përparësi kanë kandidatët që kanë njohuri të mira në zbatimin e teknikave moderne statistikore, grumbullim të të dhënave dhe hulumtime statistikore;
- Përparësi kanë kandidatët që kanë njohuri të mira në aplikimin e softuerëve statistikor, si: STATA, SPSS dhe softuerë të tjerë relevant.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim për “Programi i praktikës për studentë”;
- CV të detajuar;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për praktikë në BQK;
- Lista e notave nga universiteti përkatës;
- Një letër referencë;
- Kopja e letërnjoftimit apo ndonjë dokumenti tjetër identifikues;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është deri më **05 korrik 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet në e-mail adresën praktika@bqk-kos.org ose përmes zyrës së Arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formulari i aplikacionit mund të shkarkohet përmes faqes zyrtare: www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Thirrja për aplikim (DHËNJE TË OFERTËS)

“LEONARD MUSHKOLAJ” B.I. me numer Unik:812160737 me seli rruga Ylle Morina p.n. Komuna Deçan me pronar LEONARD MUSHKOLAJ, po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për mallrat/punët/shërbime këshilluese si në vijim: për kompanit e Interesuara për Ofertim të këtyre Makinerive dhe Paisjeve Bujqësore dhe energji solare:

1. Kombajë per korrje (qvoshe te Misrit) 4 rendore;
2. Traktor 90 HP 4x4 me kabine dhe klime,
3. Energji Solare 3 kw.

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek “LEONARD MUSHKOLAJ” B.I. - LEONARD MUSHKOLAJ (Përfituesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë (5 ditë nga data e publikimit)

Afati i dorezimit të Ofertave **10 ditë nga data e pranimit të ftesave** për kuotim, ofertat dorëzohen ne Adresen: Ylle

Morina p.n. Komuna Deçan

Për Informata Shtesë tel: **+383 43 994 006** dhe në email adresën: nardimushkoalj19@icloud.com

>> SHPLLJE TË VOGLA <<

- Dardan Zherka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi”.

- Naronë Shaqir Xhukolli shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Dr. Ali Sokoli” Prishtinë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershor deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom / Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 20.06.2024

Referenca: AAPSK – 007/2024

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	VW Golf III, ngjyrë vishnje, me targa vendore	1 copë	500.00€		
2	VW Golf II viti i prodhimit 1987,dizel, ngjyrë e kuqe-për pjesë	1 copë/për pjesë	225.00€		
3	Opel Vectra A 201,viti i prodhimit 1989, benzin, ngjyre e kaltër, me targa vendore	1 copë	400.00€		
4	Jeep Pajero, ngjyre e zeze-për pjesë	1 copë/për pjesë	200.00€		
5	Mercedes Benz 190,viti i prodhimit 1985,dizel ngjyre e zeze- për skrap	1 copë/për skrap	282.90€		
6	Audi 80, ngjyre e hirit-për skrap	1 copë/për skrap	200.00€		
7	VW Golf 6,viti i prodhimit 2010,benzin, ngjyrë e zezë metalike,me targa vendore	1 copë	4,500.00€		
8	VW Gof II,ngjyrë e bardhë-për skrap	1 copë/për skrap	202.40€		
9	VW Gof II,viti i prodhimit 1987, dizel,ngjyrë e bardhë-për skrap	1 copë/për skrap	207.00€		
10	VW Passat 35L,,viti i prodhimit 1989,dizel, ngjyre e zezë-për skrap	1 copë/për skrap	279.45€		
11	VW Golf III,viti i prodhimit 1993,benzin, ngjyre e kaltër metalike-për pjesë	1 copë/për pjesë	300.00€		
12	VW Golf III,,dizel, ngjyre e zezë--për pjesë	1 copë për pjesë	300.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohet më së largu deri më 28.06.2024 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë. Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 28.06.2024, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aapsk.rks-gov.net> apo <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Sektori i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254





TRADITË QË NGA

1992

